



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 1251/3 prot.

Tiranë, më 28.05.2023

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 1251/1, DATË 15.05.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, "PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË ANKESAVE TË BASHKUARA TË PARAQITURA NGA SHTETASIT Z. ARBEN HOXHAJ, ZNJ. VALBONA HOXHAJ, Z. ELVIS HOXHAJ"

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e shtetasve z. Arben Hoxhaj, znj. Valbona Hoxhaj, z. Elvis Hoxhaj me nr. 1305 prot., datë 23.06.2020 dhe nr. 1305/2 prot., datë 08.07.2020, ndaj veprimtarisë së magjistratëve z. A.Ç., z. S.Sh., znj. L.D., gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, z. A.M., prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe me vendimin nr. 1251/1, datë 15.05.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasit z. Arben Hoxhaj, znj. Valbona Hoxhaj, z. Elvis Hoxhaj", bazuar në nenin 121, pika 2, shkronjat a) të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendim duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Megenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Shkodër, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Kodi Postar 4001, Shkodër;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen në ambientin e bashkisë përkatëse, do të hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

